



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Datë: 06 Shkurt 2024

Gjakovë

FTESË PËR APLIKIM

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, subvencionon në formë të përkrahjes financiare qytetarët e Komunës së Gjakovës për përballimin e shpenzimeve të shërimit nga sëmundjet e rënda, rastet emergjente shëndetësore, sëmundjet e ndryshme kardiovaskulare dhe kancerogjene.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim përfshinë:

1. Formulari i kërkesës-(**aplikacioni tërhiqet në zyre të drejtorisë së Shëndetësisë**)
2. Raporti mjekësor – kopje
3. Diagnoza për të cilën po aplikon
4. Data e intervenimit të fundit
5. Faturat për shpenzime të mjekimit – kopje
6. Letërnjoftimi – Kopje
7. Llogaria bankare- (**Të gjithë aplikantët janë të obliguar të sjellin konfirmimin e xhirollogarisë bankare**).

Kriteret-(prioritet) për aplikim janë:

- Personat me sëmundje të rënda dhe me kosto të lartë të shpenzimit të mjekimit
- Personat që nuk kanë përfituar nga burimet tjera financiare
- Personat që nuk kanë përfituar gjatë dy viteve të fundit
- Personat me gjendje të rënde socio-ekonomike
- Përparësi kanë aplikantët që janë nëna vet ushqyese

Tërheqja e formularëve për aplikim bëhet në: **Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** (kati i dytë). Ndërtesa; ish-objekti i Urbanizmit
Ftesa publike është e hapur (30 dite kalendarike) nga dita e publikimit **12.02-12.03.2024** ora **16:00**.

Përzgjedhja e përfituesve bëhet nga Komisioni Vlerësues i përcaktuar nga Komuna e Gjakovës

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Postal address: Bardhyl Qaushi Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 390 320 050

<http://kk.rks-gov.net/gjakove/>